

Media dhe të Mësuarit e Gjuhës Angleze



Gjuhësi

Fjalë kyçe: media, komunikimi, informacioni, organizimi i mësimit, studenti, mësuesi, gjuhë angleze, etj.

Laureta Vavla, Florenc Vavla

Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, Shqipëri.

Abstract

Zhvillimi i vullshëm i shoqërisë së sotme, si dhe rritja me ritme marramendëse e informacionit, i ndihmuar nga mjetet e shumëllojshme të transmetimit të komunikimit, kanë bërë të mundur që mësimdhënia të ndryshojë nga ajo e dekadave të mëparshme. Më parë, mësuesi ishte burim informacioni, masë për gjithçka, ndërsa sot, ai është një udhëheqës dhe organizues i mësimit, që udhëheq studentët për të kërkuar në mënyrë të pavarur informacionin dhe, me ndihmën e tij, të zgjidhë çdo problem, pavarësisht shkallës së vështirësisë së tij. Sot, ndryshe nga më parë, në qendër të mësimit është studenti. Mësuesi rregullon e përshtat interesat e tij, në përputhje me synimet e mësimdhënies. Qëllimi i këtij punimi është të pasqyrojë anët pozitive të përdorimit sa më të gjerë të medias në auditore.

Hyrje

Universiteti dhe shkolla në përgjithësi, institucione të organizuara të arsimit të njerëzve, janë ngritur nga shoqëria që t'i shërbejnë asaj, jo vetëm për të tashmen por ndoshta akoma më me rëndësi për të ardhmen, madje duke i paraprirë ndryshimeve që sjellin zhvillim. Sot, vëllimi i njohurive është shtuar me hapa galopantë, për pasojë edhe vëllimi i informacionit ka ndërjerë të njëjtat ritme. Asnjë rregull, asnjë grup njerëzish nuk mund të përgjigjet se cila ide është më e mirë se të tjerat në një rrethanë të caktuar.

Sot nga institucionet arsimuese nuk kërkohet më si më parë riprodhimi i informacionit por universitetet dhe shkollat kanë për mision të përgatitin gjeneratat e reja me shprehitë për ta kërkuar informacionin, për të operuar me të, për ta analizuar atë në mënyrë kritike dhe për të aftësuar studentët që të jenë në gjendje të japin zgjidhje të problemeve. Universitetet sot synojnë në zhvillimin e të menduarit kritik, i cili përfshin thithjen e ideve dhe shqyrtimin e ndikimit të tyre, paraqitjen e tyre në një "skepticizëm të stërholluar"²²⁰, baraspeshimin e tyre përballë pikëpamjeve të kundërta, ndërtimin e sistemeve të besueshme, për t'i provuar ato dhe ndërmarrjen e një qëndrimi të bazuar në këto struktura.

"Mendimi kritik është një proces i ndërlikuar i përfshirjes së ideve dhe burimeve në mënyrë krijuese, i rikonceptualizimit dhe ristrukturimit të koncepteve të informacionit."²²¹ Ai është një proces njohës, veprues dhe ndërveprues, i cili ndodh, njëkohësisht në mjaft nivele të të menduarit. Ndryshimi i rolit të mësuesit ka ardhur si rezultat i zhvillimit me ritme të shpejta të shoqërisë, i 'shpërthimit të informacionit'. Tashmë, roli i tij në mësimdhënie është të orientojë proceset e të menduarit të nxënësve drejt niveleve më të larta, të kultivojë shprehitë e zgjidhjes së problemeve dhe të marrjes së vendimeve, në kushte të reja e të panjohura më parë prej tyre. Si e tillë media nuk mund të ishte lënë jashtë institucioneve edukuese dhe në rastin tonë në universitete.

Gjithnjë e më shumë shihet prania e llojeve të ndryshme të mediave në salla dhe auditore. Kështu nga një vrojtje të bërë në universitetet shqiptare dhe më specifikisht në programet mësimore të disa prej universiteteve në vendin tonë është vënë re se mediat po shohin një rritje të përdorimit të tyre në mësimdhënie. Në universitetin e Tiranës programet mësimore të të gjitha degëve përmbajnë lëndën e njohurive kompjuterike. Përsa i takon programeve të gjuhëve të huaja media ndeshet edhe në lëndë të tilla si Informatika në gjuhësi, apo e ndërthurur me "Teknika të të shprehurit dhe komunikimi".

Në universitetin e Vlorës hasen lëndë të tilla si Studime të komunikacionit apo dhe Teknologji të edukimit. Në shkencat shoqërore ka një lëndë specifike mbi përdorimin e informatikës në këtë degë. Teknikat multimediale interaktive gjenden si lëndë e vecantë në degën e teknologjisë së informacionit. Në universitetin e Elbasanit të gjitha programet mësimore të degëve përmbajnë lëndën e njohurive kompjuterike, lëndë në të cilën i vihet theksi eksplorimit të internetit për nevojat specifike të studentit në degën që ai studion.

Përsa i takon studimit të gjuhëve të huaja, në këtë universitet zhvillohen lëndë specifike mbi përdorimin e medias në mësimdhënie – lëndë kjo që nuk kufizohet mbi përdorimin e teknikave të medias në mësimin e gjuhës së huaj por edhe prek mundësitë e shumfishta të përdorimit të mediave të ndryshme në procesin mësimor.

²²⁰ Bardhyl Musai "Metodologji e mësimdhënies" Pegi, 2002

²²¹ Ibid

Llojet e medias – të përbashkëta dhe të veçanta e tyre

Pas shume vitesh dyshimesh nga ana e mësuesve, mësime dhënie e gjuhës angleze është duke adoptuar ngadalë forma të reja të teknologjisë si kontribues të pranuar dhe të respektuar në mësime dhënie. Zhvillimi i ueb, të mësuarit nëpërmjet tabelave të bardha interaktive - TBI-ve etj është gjithnjë e më i madh, dhe tashmë mësuesit e kanë akoma më të vështirë se më parë të thonë “Nuk më pëlqen të përdor teknologjitë mediatike” – dhe kjo veçanërisht për faktin sepse studentët presin gjithnjë e më shumë që përveç librit dhe tabelës së zezë në auditor të përdoren edhe forma të ndryshme teknologjike. Deri ku mund ta dërgojmë teknologjinë në procesin mësuesor?

Ose, e parë nga një këndvështrim tjetër, ku po na dërgon teknologjia në procesin mësuesor? Për vite me radhë (dhe deri diku kjo situatë vazhdon ende) teknikat e medias janë parë me dyshim – shqetësimi kryesor i shumë mësuesve të anketuar ka qënë (dhe mbetet për disa) fakti që këto teknika do të zhvendosin vëmendjen e studentëve nga qëllimet bazë të komunikimit në klasë. Shumë mësues gjuhe i kanë refuzuar laboratorët e gjuhës në të kaluarën, ndërkohë që vitet e fundit teknologjia është gjithnjë e më e pranueshme për mësuesit e rinj – ndonëse vazhdon të refuzohet nga disa në moshë të thyer. Si mësime dhënie ne besojmë se nevojat e studentit vijnë të parat.

Nëse këto nevoja mund të përmbushen me një copë shkumës dhe një tabelë të zezë – sic e koncepton edhe Scott Thornbury në “Mësime dhënie pa prizë”, atëherë kjo është perfekte. Gjithsesi, nevojat shpesh përmbushen me dëshira dhe ndonjëherë edhe me ëndrra. Studentët të cilët studiojnë nëpër institucione të ndryshme qofshin këto shtetërore apo dhe private – ku i duhet të paguajnë për mësime dhënie e marrë, janë gjithashtu konsumatorë të cilët kanë pritshmëritë dhe preferencat e tyre dhe që presin përdorimin e teknologjive të ndryshme gjatë procesit të mësimit. Kjo nuk kundërshton nevojat e tyre – me një përdorim të kujdesshëm të teknologjive ne mund të arrijmë që të pasurojmë eksperiencën e studentëve në të mësuarit dhe mund gjithashtu të kontribuojmë në përmirësimin e të të mësuarit të suksesshëm. Sapo të kemi pranuar që përdorimi i teknologjive të medias në procesin mësuesor luan rol në suksesin e mësime dhënie nga ana e studentit (qoftë ky rol edhe ai i ruajtjes së motivimit) atëherë duhet të përkushtohemi në dhënie e opsioneve online si për zhvillimin e mësuesit ashtu edhe të studentit, duke informuar teorikisht dhe duke u fokusuar në praktikën më të mira të aplikuara në vend dhe jashtë tij.

Gazetat dhe revistat në klasë

Është e lehtë të sjellësh gazetën në klasë në lëndë të ndryshme, veçanërisht në gjeografi, histori, letërsi, gjuhë të huaj etj. Disa prej gazetave kanë informacione shumë të vyerës për ata që i përkasin këtyre lëndëve, por ne duhet të dimë sesi ta kërkojmë e ta gjejmë këtë informacion. Shumë biblioteka kanë sisteme klasifikimi sipas temave apo çështjeve të caktuara dhe ne mund ta gjejmë lehtësisht informacionin që jemi duke kërkuar. Nëse jo, dhe ky është rasti i shumë prej bibliotekave në vendin tonë, atëherë do të na duhet të shpenzojmë shumë më tepër kohë për të gjetur atë që duam. Pas gjetjes së informacionit ne mund ta fotokopjojmë atë ose dhe mund të presim me gërshtëri pjesët që na nevojiten dhe mund ta sjellim atë në klasë, duke e interpretuar ose thjesht duke e përdorur ashtu siç është.

Pak vite më parë ne e kishim shumë të vështirë për të mos thënë të pamundur të gjenim gazetën të huaj, ne nuk mund të kishim kështu materiale autentike për të përdorur në klasë por tani ky realitet ka ndryshuar dhe ne mund të gjejmë shumë gazeta të cilat mund t'i sjellim në klasë e mund t'i përdorim si informacione plotësuese në shumë lëndë gjithnjë e më shumë të llojit të gazetës. Kështu në histori mjaft artikuj mbi tema aktuale të çështjeve më të nxehta në botë mund të ishin shumë me vlerë. Duke marrë artikuj nga gazeta të ndryshme mbi të njëjtën temë, për shembull mbi çështjen e njohjes së shtetit të ri të Kosovës, do të mund të organizohet një diskutim mjaft me vlerë mes studentëve mbi arsyet e njohjes apo mosnjohjes nga vende të ndryshme, interesat gjeopolitike që ndërhyjnë në marrjen e këtyre vendimeve etj. Në fund të orës mund t'i kërkohej studentëve të shkruanin një ese me temë “Përse nuk e njeh Serbia Kosovën si shtet të pavarur e sovran?” Ekzistojnë mënyra nga më të ndryshmet për të përdorur gazetën në orë të mësimit të gjuhës së huaj. Gazetat për shembull mund të përdoren për kulturën që ato transmetojnë.

Zakonisht gazetën reflektojnë kulturën e një komuniteti të caktuar dhe e shfaqin këtë nëpërmjet gjuhës që ata përdorin. Ato përbëjnë një burim shumë të vyer të këtyre llojeve informacioni dhe sa më shumë që studentët të lexojnë, aq më shumë do të arrijnë ata të kuptojnë këtë kulturë. Duke e parë në këtë këndvështrim, në punën time me studentët të degës së Psikologjisë dhe Punës Sociale kam arritur të realizoj rreth 10 orë mësime të cilat kanë patur në bazë të tyre artikuj të marrë nga gazeta të ndryshme të huaja. Kështu një prej temave të trajtuara në këto orë ishte “Trajtimi i të burgosurve nëpër burgjet evropiane” dhe sjellja në klasë e historive reale dhe e paraqitjes së këndvështrimeve të ndryshme ishte mjaft me interes për studentët. Ato jo vetëm që u treguan mjaft të zellshëm për të lexuar artikujt e sjellë në klasë por arritën të realizonin një diskutim mjaft frytdhënës ku u panë rrahje idesh shume kritike dhe për më tepër u arrit që studentët të merrnin përsipër shkrimin e një eseje të shkurtër mbi “A është e nevojshme të hapen burgje për minorenë?”.

Duke marrë shkas nga esetë e shkruara nga studentët u konstatua se me anë të disa artikujve marrë nga gazeta autentike të cilat përdorin një gjuhë shumë të pastër dhe të jetës reale – studentët jo vetëm që zhvillojnë më tej aftësitë e tyre në të lexuar, por edhe aftësitë e tyre në të shprehur, në një të menduar kritik e për më tepër në të shkruar. Një aspekt tjetër i gazetave është se ato duke reflektuar një gjuhë autentike arrijnë të reflektojnë edhe ndryshimet që ndodhin në gjuhë. Në këtë mënyrë është akoma më e rëndësishme përdorimi i tyre në klasë pasi studentët dhe mësuesit kanë mundësi që të jenë në të njëjtin ritëm dhe hap me këto lloje

ndryshimesh. Gazetat përmbajnë një variacion shumë të larmishëm tipesh tekste dhe stilesh gjuhësore, të cilat nuk mund të gjenden në librat shkollorë.

Në të njëjtën kohë gazetatat përmbajnë një burim natyral të shumë varieteteve të anglishtes së shkruar që është shumë e rëndësishme për studentët, si dhe shumë me vlerë për studimin e gjuhës. Kështu gazetatat mund të përdoren si materiale shtesë në Analizë Teksti, Shkrim Akademik, Stilistikë, Semantikë etj gjatë analizës së tipeve të ndryshme të teksteve. Larmia e temave dhe çështjeve që gjenden nëpër gazeta i bëjnë këto të fundit, interesante dhe motivuese për studentët. Gazetat raportojnë ngjarje të jetës reale, dhe kjo gjë shton kuriozitetin e studentëve.

Aktivitetet që kanë në bazë të tyre gazetatat kanë rezultuar se i angazhojnë studentët në aktivitete të këndshme dhe inkurajojnë të lexuarit e mëtejshëm. Gazetat janë një burim mjaft me vlerë i materialeve autentike, dhe përdorimi i tyre në orët e mësimit të gjuhës së huaj është shumë i rëndësishëm sidomos për ata që përket të menduarit kritik dhe praktik. Përdorimi i materialeve të marra nga gazetatat në klasë është shumë i nevojshëm edhe për ato studentë që synojnë të shkojnë të jetojnë e punojnë në vende të ndryshme. Diversiteti i informacionit të gjendur në gazeta i jep mundësi mësuesve që të përzgjedhin materiale të cilat mund t'i përshatën më së miri studentëve të tyre. Sa më shumë që studentët lexojnë aq më shumë do të duan ata të eksplorojnë. "Njerëzit mësojnë duke lexuar, dhe të lexuarit e ngjarjeve të reja dhe interesante në një lëndë të caktuar, pa asnjë dyshim që ndihmon në motivimin e studentit."²²²

Gazetat gjithashtu janë një burim tejet i vyer për mësuesit e anglishtes për qëllime specifike. Ato mund të përdoren si materiale mësimore për të zhvilluar aftësitë gjuhësore të studentit. Kështu, përdorimi i gjerë i gazetave të huaja britanike dhe amerikane me studentët e gazetarisë ka qenë një iniciativë tejet frytdhënëse për këta studentë. Është parë se ata jo vetëm që janë treguar shumë më të interesuar e më të motivuar se në orët e tjera tradicionale por është parë se ata janë treguar të gatshëm të vihen në kërkim të këtyre gazetave për të parë gjithashtu edhe gjuhën e përdorur në artikuj e gazeta të ndryshme si edhe për të vërejtur me kujdes stilin gazetaresk në shkrime.

Për t'u vlerësuar e për t'u përmendur është dhe fakti se pas përdorimit të këtyre gazetave në orët e mësimit, është vënë re se edhe ata studentë që mund të qëndronin pasiv në orët e mëparshme janë vënë në lëvizje dhe kanë arritur të aktivizohen e motivohen më tej. Duke qënë se gazetaria është fusha e tyre e studimit atëherë dhe mjeti i përdorur për t'i afruar ato drejt anglishtes ka qënë po nga ky lëm pra nga lëmi i gazetarisë. Kështu gazetatat mund të përdoren në mënyrë të efektshme në të gjitha nivelet e mësimit të një gjuhe të huaj duke nisur nga ai elementari deri tek i avancuari. Të pasurit e kaq shumë gazetave dhe informacioneve kërkon që mësuesit të jenë më të kujdesshëm me mënyrën sesi ata do të organizojnë një aktivitet të caktuar duke përdorur një gazetë. Kështu që duhet zgjedhur një artikull i cili duhet të jetë i përshtatshëm për klasa ku niveli i studentëve mund të jetë i larmishëm.

Gjatë planifikimit të mësimit në të cilin do të përdoren gazetatat, është e nevojshme të merret parasysh gjatësia e artikullit, paragrafit, kompleksiteti i gjuhës, densiteti i informacionit, përmbajtja, koha që është në dispozicion, dhe niveli i studentëve. Ndonëse numri i gazetave në gjuhën angleze në vendin tonë është deri diku i limituar, mësuesit e anglishtes mund të gjejnë mënyra të ndryshme për të gjetur disa.

Mënyrat që unë kam përdorur kanë qënë organizata të ndryshme të cilat sjellin gazeta apo dhe revista të ndryshme apo dhe bashkëpunimi me mësues të tjerë me të cilët kemi ndarë materiale të ndryshme. Ditët e sotme, jetojmë në një periudhë ndryshimesh të shpejta teknologjike. Pra nëpërmjet Internetit mund të fitojmë akses në qindra gazeta dhe revista në të gjithë botën. Një kujdes mjaft i vecantë i duhet kushtuar organizimit të materialeve marrë nga gazetatat. Sapo të nisim mbledhjen e këtyre materialeve duhet menduar organizimi i tyre, ndarja nëpër kategori të veçanta, sistemimi i tyre etj. Secili prej nesh besoj se ka përjetuar frustrimin se ai/ajo e di që e ka këtë material por nuk e di se ku e ka lënë.

Është shumë ndihmëse ndarja e materialeve sipas titujve, kryeartikujve, reklamave etj. Përgatitja e materialeve marrë nga gazeta për përdorim në klasë i motivon studentët të lexojnë gazetën. Të një rëndësie të vecantë janë përdorimi i fotove dhe ilustrimeve. Ne duhet të kemi kujdes që t'i përgatisim këto materiale sa më mirë të mundim në mënyrë që t'i përdorim ato në vazhdimësi, dhe me kalimin e kohës ne mund të krijojmë dosje të veçanta e t'i pasurojmë ato. Një ilustrim mjaft i mirë i asaj cka thamë më lart është përdorimi i të njëjtat fotove dhe imazheve me studentët e degëve të anglishtes, gazetarisë, psikologjisë dhe punës sociale. Të njëjtat imazhe janë përdorur në mënyra të ndryshme me këto nivele të ndryshme studentësh.

Kështu me studentët e anglishtes së vitit të katërt një grup imazhesh të cilët kishin të përbashkët temën e "Friendship" janë përdorur në mënyrë të tillë që studentët të fillonin të mendonin në mënyrë kritike mbi atë se çfarë ndryshimesh mund t'i sjellë në jetën e tyre një shoqëri e mire ndaj ndryshimeve të ardhura nga një shoqëri i keqe. Ky aktivitetet u kurorëzua me një debat mbi rëndësinë e shoqërisë në jetën e secilit prej nesh.

Ndërkohë të njëjtat imazhe marrë nga gazetatat u përdorën me studentët e psikologjisë dhe punës sociale për të ilustruar gjendjen emocionale të njerëzve që paraqiteshin në foto duke nxitur kështu të folurin dhe përdorimin e sa më shumë mbiemrave. Në vijim, me studentët e gazetarisë të njëjtat imazhe u përdorën për të nxitur studentët në shkrimin e artikujve që mund të

²²² Paul Sanderson, "Using newspapers in the Classroom" CUP 2002

ilustroheshin me këto imazhe. Në fund studentëve iu lexuan artikujt realë përkatës dhe në këtë mënyrë studentët u ndjenë shumë më të motivuar për të vazhduar më tej në punën e tyre në shkrimin e gjuhës angleze si edhe në leximin e artikujve në gazeta të huaja.

Përfundime

Një vrojtim tjetër mjaft i rëndësishëm i cili duhet patur parasysh gjatë përdorimit të materialeve marrë nga gazetatat është se vetëm fakti që ne mendojmë se një artikull i caktuar i cili është i vështirë për studentët nuk duhet përdorur me ta. Është e vërtetë që gjuha e përdorur mund të jetë e vështirë por kjo nuk do të thotë që ne nuk duhet ta përdorim sepse në fund të ditës kjo gjuhë është autentike që është mjaft me vlerë.

Ka shumë mënyra sesi mund të përdorim materiale të tilla me nivele të ndryshme studentësh. Kështu nëse ne gjejmë artikuj shumë interesantë, atëherë studentët ndonëse do ta kenë pak të vështirë të kuptojnë gjuhën e përdorur aty do të shtyhen nga interesi për të mësuar se çfarë fshihet pas paragrafëve që ata nuk kuptojnë duke i shtyrë ata kështu të eksplorojnë akoma më shumë në gjuhën e huaj që ata po mësojnë.

Ne të gjithë e dimë se motivimi është tejet i lidhur me interesin që studenti ka, kështu që është shumë e rëndësishme që ne t'i mbajmë studentët të interesuar në të lexuarin në përgjithësi si edhe në të lexuarin e gazetave në veçanti. Si përfundim, mbetet e rëndësishme përzgjedhja e aktiviteteve që do të zhvillohen me materialet e marra nga gazetatat. Aktivitetet mund të jenë të shumta, interesante dhe multi-dimensionale. E rëndësishme është përzgjedhja dhe përshtatja e tyre me nivelin e studentëve.

Bibliografia

1. Bardhyl Musai "Metodologji e mësimdhënies" Pegi, 2002
2. Davies, P., dhe E. Pearse. 2000. Success in English teaching. Oxford:Oxford University Press
3. Harmer J. 1994. The practice of English language teaching. London : Longman; Raimes, A. 1983. Techniques in teaching writing. Oxford: Oxford University Press.
4. Hedge, T. 1993. Writing. Oxford: Oxford University Press
5. Paul Sanderson, "Using newspapers in the Classroom" CUP 2002
6. Raimes, A. 1983. Techniques in teaching writing. Oxford: Oxford University Press.